



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2017 – Numri: 247

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E mërkurë, 14 shkurt 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 28, datë 29.12.2017	Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të Maturës Shtetërore 2018..... 13471
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për heqjen e zotësisë për të vepruar dhe caktimin e kujdestarisë për shtetasin Prelë Vatë Lulaj..... 13473



UDHËZIM

Nr. 28, datë 29.12.2017

**PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN
E PROVIMEVE KOMBËTARE TË
MATURËS SHTETËRORE 2018**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 51, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 7, pika dh), dhe nenit 8, pika b), të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJMË:

1. Provimet e Maturës Shtetërore 2018 për shkollat e mesme të përgjithshme të jenë:

a) Provime të detyruara: “Gjuhë shqipe dhe letërsi”, “Matematikë” dhe “Gjuhë e huaj”.

b) Provime me zgjedhje.

2. Provimet e Maturës Shtetërore Profesionale 2018 për shkollat e mesme profesionale të jenë:

a) Provime të detyruara: “Gjuhë shqipe dhe letërsi”, “Matematikë”, “Gjuhë e huaj” dhe “Teori profesionale e integruar” sipas drejtimit/profilit që maturanti/kandidati ka ndjekur në shkollë.

b) Provimi me zgjedhje.

3. Testi i gjuhës së huaj (D3) hartohet në përputhje me gjuhën, e cila, në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë, trajtohet si gjuhë e huaj në nivelin gjuhësor B1.

4. Lista e gjuhëve të huaja që jepen si provim i detyruar (D3), është: anglisht, frëngjisht, italisht dhe gjermanisht. Gjuha e huaj si provim i detyruar përzgjidhet gjatë plotësimit të formularit A1/A1Z. Kandidatët e maturave shtetërore të viteve 2014, 2015, 2016 dhe 2017 që kanë rezultuar jokalues në provimin D3, duhet ta rijapin këtë provim. Kandidatët e tjerë, që aplikojnë me A1Z, nuk do ta rijapin provimin e detyruar D3.

5. Lista e lëndëve të provimeve me zgjedhje:

Nr.	Lënda	Kredite
I	SHKOLLAT E MESME TË PËRGJITHSHME DHE PROFESIONALE	
1	Gjuhë e huaj	10
2	Letërsi e thelluar	5
3	Matematikë e thelluar	5
4	Kimi bërthamë	4
5	Kimi e thelluar	6
6	Fizikë bërthamë	4
7	Fizikë e thelluar	6
8	Biologji bërthamë	4
9	Biologji e thelluar	6
10	Histori bërthamë	5
11	Histori e thelluar	9
12	Gjeografi bërthamë	5
13	Gjeografi e thelluar	7
14	Ekonomi bërthamë	2
15	Ekonomi e thelluar	4
16	Teknologji bërthamë	2
17	Teknologji e thelluar	4
18	Qytetari	3
19	Psikologji	2
20	Filozofi	2
21	Sociologji	2
II	SHKOLLAT ARTISTIKE	Kredite
22	Histori muzike	6
23	Histori arti	6
24	Histori baleti	3



6. Lista e provimit të detyruar të teorisë profesionale të integruar sipas drejtimit/profilit që maturantët/kandidatët kanë ndjekur në shkollat profesionale:

Nr.	Lënda	Kredite
	DREJTIMI/PROFILI PROFESIONAL	
1	Hoteleri-turizëm	8
2	Shërbime mjetesesh transporti	8
3	Mekanikë	8
4	Elektroteknikë	8
5	Elektronikë	8
6	Përpunim druri	8
7	Ndërtim	8
8	Tekstil-konfeksione	8
9	Teknologji ushqimore	8
10	Bujqësi	8
11	Shërbime sociale dhe shëndetësore	8
12	Instalues i sistemeve termohidraulike	8
13	Teknologji kimike	8
14	Peshkim	8
15	Gjeologji-miniera	8
16	Llogari	8
17	Shërbime bankare	8
18	Sipërmarrje e agjencisë turistike	8
19	Sigurime	8
20	Tregti	8
21	Administrim biznesi	8
22	Rrjete të dhënash	8
23	Mbështetje e përdoruesve të TIK-ut	8
24	Zhvillim <i>website</i>	8
25	Rrjete të dhënash (pilot-giz)	8
26	Inxhinieri informatike <i>software</i> -sh (Hermann Gmeiner)	8
27	Silvikulturë	8
28	Agrobiznes	8
29	Veterinari	8
30	Gjcodezi	8
31	Biznes (Harry Fultz)	8
32	Elektronikë (Harry Fultz)	8
33	Automekanik (Harry Fultz)	8
34	Teknologji informacioni (Peter Mahringer)	8

7. Testi i gjuhës së huaj si lëndë me zgjedhje do të hartohet në nivelin gjuhësor B2.

8. Lista e gjuhëve të huaja si lëndë me zgjedhje përcaktohet në udhëzuesin për plotësimin e formularit A1/A1Z.

9. Programet orientuese të lëndëve të detyruara (“Gjuhë shqipe dhe letërsi”, “Matematikë” dhe “Gjuhë e huaj”) për të gjithë maturantët/kandidatët e shkollave të mesme të përgjithshme janë në përshtatje me programet ekzistuese të shkollave të mesme të përgjithshme.

10. Programet orientuese të provimeve të detyruara (“Gjuhë shqipe dhe letërsi”, “Matematikë”, “Gjuhë e huaj” dhe “Teori profesionale e integruar”) për maturantët/

kandidatët e shkollave profesionale janë në përshtatje me programet ekzistuese të shkollave profesionale.

11. Programet orientuese të lëndëve me zgjedhje janë të njëjta për të gjithë maturantët/kandidatët që plotësojnë formularin A1/A1Z.

12. Programi orientues i një lëndë të thelluar përmban edhe programin e lëndës bërthamë (përfshihen këtu lëndët e provimeve të detyruara).

13. Lënda “Gjeografi” (bërthamë dhe e thelluar) përmban edhe lëndën “Shkenca e tokës”.

14. Maturanti/kandidati i shkollave të mesme të përgjithshme zgjedh dy lëndë nga lista e lëndëve



me zgjedhje, sipas tabelës në pikën 5, pavarësisht nëse i ka zhvilluar ose jo, apo i janë ofruar ose jo ato nga shkolla në planin mësimor.

15. Maturanti/kandidati i shkollave të mesme profesionale zgjedh vetëm një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje (me vlerë krediti 2-10), sipas tabelës në pikën 5, pavarësisht nëse i ka zhvilluar ose jo, apo i është ofruar ose jo nga shkolla në planin mësimor.

16. Maturanti/kandidati i shkollave artistike koreografike ka të drejtë të zgjedhë nga lista e lëndëve sipas tabelës 5:

a) Lëndën e parë, nga grupi i lëndëve II, “Shkollat artistike”.

b) Lëndën e dytë, nga grupi i lëndëve I, “Shkollat e mesme të përgjithshme dhe profesionale”.

17. Maturanti/kandidati i shkollave të mesme të përgjithshme zgjedh lëndët për provimet me zgjedhje sipas këtyre kritereve:

a) Shuma e krediteve të këtyre lëndëve të jetë jo më e vogël se 8 (tetë).

b) Numri i lëndëve të jetë 2 (dy).

18. Maturanti/kandidati, kur zgjedh një lëndë të thelluar, nuk mund të zgjedhë njëkohësisht të njëjtën lëndë bërthamë (përrjashtuar lëndët “Gjuhë shqipe dhe letërsi”, “Matematikë”, “Gjuhë e huaj”).

19. Kandidatit që ka dhënë dy ose më shumë provime me zgjedhje dhe është vlerësuar me notë të përrshkallëzuar jo më të vogël se 4.50 (nota 5), i njihen ato provime dhe nuk mund t’i rriapë më.

20. Kandidati që rezulton mbetës në të paktën njërin prej provimeve të Maturës Shtetërore ose të Maturës Shtetërore Profesionale, duhet ta rriapë provimin që të pajiset me diplomë.

21. Kandidati që në Maturën Shtetërore 2012 ka zgjedhur për të dhënë 3 (tri) provime me zgjedhje:

a) nëse ka mbetur në dy provime, të zgjedhë vetëm një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje të këtij udhëzimi;

b) nëse rezulton kalues në dy prej tyre, të pajiset me diplomën e Maturës.

22. Kandidatit që ka marrë dëftesë pjekurie para vitit 2011 dhe dëshiron të aplikojë për studime në institucionet e arsimit të lartë, t’i njihen provimet e detyruara ose provimet e njëvleftshme me to, të njësuara nga DAR/ZA-ja. Në rastet kur nuk ka dhënë provime me zgjedhje ose i ka dhënë dhe nuk ka rezultuar kalues, kandidati ka të drejtë të japë

provime me zgjedhje kur e ka të nevojshme për plotësimin e kritereve të pranimit të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë.

23. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi zëvendësministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë; zëvendësministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Sekretari i Përgjithshëm i MASR-së; Drejtoria e Zhvillimit të Programeve të Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Qendra e Shërbimeve Arsimore; Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve; Inspektorati Shtetëror i Arsimit; Instituti i Zhvillimit të Arsimit; njësitë arsimore vendore dhe institucionet arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

MINISTRI I FINANCEVE DHE
EKONOMISË
Arben Ahmetaj

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 1504 (5031), datë 30.11.2017, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Prelë Lulaj, lindur dhe banues në Velipojë, vendosjen e shtetasit Prelë Vatë Lulaj nën kujdestarinë e bashkëshortes së tij, shtetasës Gjyste Lulaj.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 56 lekë